




Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Komuna Gjilan

Opstina Gnjilane

Municipality of Gjiçan



Islamic Relief Kosova

Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari

Direkcija za Poljoprivredu Šumarstvo

Department of Agriculture Forestry

DATË/A:	17.08.2023
PËR/ZA/TO	Për Fermerët e Komunës së Gjilanit
Njoftim	Zyrës së Kryetarit të Komunës Gjilan z. Alban Hyseni
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari - Bajram Isufi
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Thirrje për Aplikim për grante për fermerët e komunës së Gjilanit

Bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit të Islamic Relief- Zyra në Kosovë dhe Komunës së Gjilan-it. Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari, në bashkëpunim me organizatën Islamic Relief hapin thirrjen e aplikimeve për grante të vogla bujqësore.

Ftohen për aplikim të gjithë fermerët e Komunës së Gjilanit, të interesuarit për njërin nga këto grante;

1. 12 Përfitues (serra) me 500 m²
2. 30 Panele Solare
3. 120 Lopë Qumështore

Kriteret që duhet të plotësojë aplikuesi për serra:

1. Përparësi kanë fermerët të cilët nuk kanë përfituar grante në tre vitet e fundit.
2. Aplikuesit të cilat aplikojnë për serra duhet të kenë tokë të punueshme (kopshte me perime) dhe vendin për vendosjen e serrës në sipërfaqe prej 500m²
3. Aplikuesit të cilat aplikojnë për serra 500 m² duhet të kenë përvojë pune në serra dhe duhet të posedojnë serra me të vogla se 500 m² në fermat e tyre

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim për serra:

1. Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës
2. Vërtetimi i tatimit në pronë (origjinal)
3. Certifikata e bashkësisë familjare
4. Fleta poseduese e patundshmërisë bashkë me skicën e parcelës ku do të vendoset serra (origjinal)

Kriteret që duhet të plotësojë aplikuesi për panele solare:

Përparësi kanë fermerët të cilët plotësojnë këto kritere:

1. Fermerët që mbarështojnë së paku 10 krerë lopë, 100 dele – dhi
2. Fermerët që mbarështojnë pula vojse ose brojler mbi 2000 mijë copë
3. Fermerët që prodhojnë perime në serra mbi 500m²
4. Fermerët që kultivojnë pemë drufrutore ose pemë të imëta mbi 1 hektarë
5. Fermerët që kultivojnë perime në fushë të hapur mbi 0.5 hektarë

Dokumentacioni i nevojshëm për panele solare:

1. Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës
2. Vërtetimi i tatimit në pronë (origjinal)
3. Fleta poseduese e patundshmërisë (origjinal)
4. Certifikata e bashkësisë familjare
5. Regjistri i kafshëve në ambulancat veterinarë (AVU)
6. Për pemëtarët dhe perimtarët - raportit EFR-së
7. Mbarështuesit e pulave vojse, brojlerëve të sjellin dëshminë e raportit të EFR-së

Kriteret që duhet të plotësojë aplikuesi për lopë qumështore:

Përparësi kanë fermerët të cilët i plotësojnë këto kriteret:

1. Të posedojë fermë adekuate që i plotëson standardet sipas mirëqenies së kafshëve për lopë qumështore.
2. Fermerët që momentalisht që kanë në mbarështim 1 deri në 4 lopë qumështore.
3. Fermeri duhet të ketë mbi 1 hektarë tokë të punueshme si dhe sasi të mjaftueshëm të ushqimit.
4. Fermerët përfitues nga Donacioni i Shkollës Bujqësore 'ARBËRIA' dhe Donatorët tjerë si IRC dhe OZHR "Mështjerra" nuk mund të jenë përfitues nga ky projekt
5. Përparësi kanë fermerët të cilët kanë punë primare bujqësinë – blegtorinë

Dokumentacioni i nevojshëm për lopë qumështore:

1. Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës
 2. Vërtetimi i tatimit në pronë (origjinal)
 3. Fleta poseduese e patundshmërisë (origjinal)
 4. Certifikata e bashkësisë familjare
 5. Regjistri i kafshëve në Ambulancat Veterinare (AUV)
- Në kushte të barabarta kanë përparësi familjet me fëmijë jetim si dhe familjet me kushte ekonomike jo të mira
 - Fermerët përfitues duhet të participojnë me 20% të çmimit të grantit

Vërejtje: Fermerët mund të aplikojnë vetëm në njërin nga grantet e mësipërme.

Afati për aplikim është nga data **17.08.2023** deri më **05.09.2023**

Aplikimet të dorëzohen në Qendrën për Shërbime me Qytetarë.